

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"RENTOUT" SH.P.K**

Sot, më datë 27 / 09 / 2023, të pranishëm:

- **Z. Fatjon Molla**, shtetas shqiptar, lindur më 13 / 08 / 1988 në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 033996349 dhe numër personal I80813060J, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Z. Endrit Molla**, shtetas shqiptar, lindur më 06 / 06 / 1987 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit ID me nr. 032885429 dhe me nr. Personal I70606067A, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Në cilësinë e ortakëve themelues me vullnet të lirë dhe të plotë, në përputhje me legjislacionin shqiptar si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i përditësuar;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i përditësuar;
- Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i përditësuar;
- Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 10128, datë 11.5.2009, "Për Tregtinë Elektronike", i përditësuar;
- Ligji nr. 107/2015, për një shtesë në ligjin 9918, "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i përditësuar;

**KREU I**

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**



Themelohet një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "RENTOUT" sh.p.k dhe domain zyrtar online [www.rentout.car](http://www.rentout.car) më poshtë "Shoqëria".

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën : Rruga "Sami Frashëri", ndërtesa nr.9, hyrje nr. 4, njësia administrative nr. 10, 1001 Tiranë, Shqipëri.

**NENI 3**  
**OBJEKTI**

Objekti ku shoqëria RENTOUT sh.p.k do të ushtrojë aktivitetin, pas regjistrimit sipas legjislacionit në fuqi në Qendrën Kombëtare të biznesit do të jetë për:



- Kryerja e veprimeve tregtare në rrugë elektronike, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve online nga platforma të dedikuara dhe programe në formatin IOS dhe Android për qiradhënien e sendeve të luajtshme nga shoqëria ose palë të treta për klientë fundorë;
- Dhënien e mjeteve me qira, si : autoveturat, automjetet e transportit të përzier, motorëve, kamionëve, autobusëve, automjet për transport të vecantë, gjysëm rimorkio, ciklomotorr, tërheqës, automjet për përdorim të vecantë, rimorkio për transport mallrash, makina bujqësore, traktor bujqësor, motokarro, makinë teknologjike, ciklomotorr me disa rrota, automjete elektrike, makina teknologjike për ndërtim ose mirëmbajtje, rimorkio kamp, mjete lundruese, varka dhe mjetet fluturues;
- Shitjen e policave të sigurimit për mjetet motorike, mjetet lundruese, pasagjerë ose persona fizikë;
- Marketimi, promovimi, shitjen, blerjen, tregtimin, qiradhënien dhe përdorimin e produkteve, shërbimeve, sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme brenda dhe jashtë vendit;
- Ofrimin e shërbimit të asistencës telefonike dhe shërbimit të specializuar në terren;

Për të realizuar objektin dhe qëllimin e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tjetër tregtar, juridik, financiar, promocional apo dorëzanës që e vlerëson të dobishëm ose të nevojshme për arritjen e objektivave të saj, sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 4 KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të fillojë me regjistrimin e saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare dhe do të jetë e pakufizuar, deri sa mbyllet me akte përkatëse ligjore.

#### **NENI 5 DEGËT DHE ZYRAT E PËRFAQËSIMIT**

Shoqëria me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve, mund të hapë shoqëri të reja, seli dytësore, filiale, zyra përfaqësimi, degë në Shqipëri ose jashtë saj.

#### **NENI 6 PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE**



Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "RENTOUT" sh.p.k dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

### **KREU II**

#### **NENI 7 KAPITALI THEMELTAR**

7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10000 (dhjetë mijë) lekë dhe është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale të secilës prej 5000 (pesëmijë) lekë.

Kapitali i mësipërm zotërohet dhe është paguar tërësisht në të holla nga dy ortakët e shoqërisë:

- **Fatjon Molla** zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit, me vlerë nominale 5000 (pesë mijë) lekë.
- **Endrit Molla** zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit, me vlerë nominale 5000 (pesë mijë) lekë.

7.2 Kontributet që përbëjnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga ortakët.

## NENI 8

### ZMADHIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR

8.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8.2 Zmadhimi i kapitalit të regjistruar, në rastin e ortakëve me kuota të barabarta bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me 3/4 (tre të katërtat) e kuotave të ortakëve të shoqërisë. Nëse nuk arrihet ky kuorum, ortakët duhet ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 30 ditëve nga kërkesa e ortakut ose ortakëve.

8.3 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

## NENI 9

### ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR TË REGJISTRUAR

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit, jep efektet mbi ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital, me përjashtim të rastit kur në baze të ligjit ose të statutit Asambleja e Përgjithshme mund të vendosi ndryshe.



9.3 Zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, në rastin e ortakëve me kuota të barabarta bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me 3/4 (tre të katërtat) e kuotave të ortakëve pjesëmarrës. Nëse nuk arrihet ky kuorum, ortakët duhet ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 30 ditëve nga kërkesa e ortakut ose ortakëve.

## NENI 10

### KALIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TË REGJISTRUAR

10.1 Kuotat e kapitalit mund t'u kalohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas parashikimeve ligjore përkatëse ose sipas kushteve të mëposhtme:

- a. Ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për kuotën që dëshirojnë të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë. Ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij, ia ofron atë ortakëve të



tjerë pas njoffimit zyrtar nëpërmjet administratorit. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin çmim që ortaku mund t'ia shesë këtë kuotë një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.

- b. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, ortakët e tjerë duhet të përgjigjen për ushtrimin e të drejtës së parablerjes ose në të kundërt, do të konsiderohet se ata kanë hequr dorë prej saj. Në rast se ortakët që do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes janë më shumë se një, kuota ndahet ndërmjet tyre në pjesë të barabarta. Në rastin e pamundësisë së një prej ortakëve që ushtron të drejtën e parablerjes për të blerë pjesën e barabartë që i takon, ky i fundit mund të blejë pjesën e barabartë ose më pak.
- c. Në rast se ortakët nuk e ushtrojnë të drejtën e parablerjes për kuotën që dëshiron të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë atëherë kjo e drejtë mund të ushtrohet nga vetë Shoqëria. Ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij, ia ofron atë Shoqërisë. Shoqëria ka të drejtën e parablerjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin çmim që ortaku mund t'ia shesë këtë kuotë një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri. Brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, shoqëria duhet të ushtrojë të drejtën e parablerjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ajo ka hequr dorë prej saj. Në rast se shoqëria vendos ta ushtrojë të drejtën e parablerjes ajo duhet të autorizojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me 3/4 (tre të katërtat) e kuotave të kapitalit themeltar, administratorin për të blerë kuotën dhe të vendosë anulimin e saj. Në këtë rast, Shoqëria duhet të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vlerën nominale të kuotës së anuluar. Si pasojë e këtij zvogëlimi të kapitalit do të ndryshojë edhe raporti i pjesëmarrjes në kapital të ortakëve të shoqërisë.
- d. Në rast se ortaku që tjetëron kuotën e vet, ia shet atë një të treti jashtë Shoqërisë, me çmim në kushte më të favorshme nga ato që i ka ofruar ortakëve dhe shoqërisë për efekt të ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ana e tyre, atëherë kontrata e shitjes që ortaku do të lidhë me personin e tretë do të jetë e pavlefshme dhe shoqëria nuk do të japë miratimin për këtë kalim.
- e. Pëlqimi i ortakëve mund të mohet nëse blerësi i propozuar:
- është i dënuar me vendim gjyqësor ose është në proces, për një vepër penale.
  - i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, ka falimentuar ose ka shpallur procedurat e falimentit.
  - në momentin e transferimit të kuotave, nuk merr përsipër detyrimet që i takonit ortakut shitës.
  - ushtron për llogari të vet ose të dikujt tjetër një veprimtari konkurruese për Shoqërinë.



Në rast mohimi të blerjes së kuotave të shpallura në shitje, për arsyet e mësipërme, zbatohen procedurat dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

10.2 Të gjitha njoffimet në funksion të zbatimit të këtij neni do të behën me shkrim me letër të porositur (rekomanduar).

### **KREU III**

#### **NENI 11 ORGANET E SHOQËRISË**

11.1 Organet e Shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe Administratori i saj. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është organi i vetëm vendim marrës i Shoqërisë dhe vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe Statutin e Shoqërisë.



11.2 Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- j) anulimin e kuotave;
- l) largimin ose përjashtimin e ortakut;
- ll) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

11.3 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali duhet të kryhet në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore përkatëse.

11.4 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme bëhet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

## **NENI 12 KUORUMI**



12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse arrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se tri të katërtat e numrit total të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shpresë, apo mjete elektronike të certifikuara dhe të sigurta, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

12.2 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **NENI 13 MARRJA E VENDIMEVE**

13.1 Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, Asambleja e Përgjithshme vendos me 3/4 (tre të katërtat) e kuotave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 12 të këtij statuti, për ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin apo prishjen e shoqërisë.

13.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.



## NENI 14 ADMINISTRATORI

14.1 Administratori i Shoqërisë është organi ekzekutiv i Shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë, që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

14.2 Administratori i Shoqërisë është:

- **Z. Endrit Molla**, shtetas shqiptar, lindur më 06 / 06/ 1987 në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 032885429 dhe numër personal I70606067A, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

14.3 Administratori ka kompetencat e mëposhtme për administrimin e shoqërisë:



- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë së Shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- përfaqëson ligjërisht Shoqërinë tregtare dhe përmbush objektivat e saj;
- kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- kryen veprimet e nevojshme të Shoqërisë, si parashikohen në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme, në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçante për Shoqërinë;
- mban librin e adresave të ortakëve të Shoqërisë;
- përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- propozon për miratim përpara Asamblesë së Përgjithshme krijimin, hapjen apo mbylljen e degëve, zyrave dhe filialeve të Shoqërisë brenda dhe jashtë Shqipërisë;
- kryen detyra të përcaktuara në ligj dhe në Statut;

14.4 Në rastin e dy ose më shumë administratorëve, secili prej tyre mund të ushtrojë veçmas të gjitha veprimet për administrimin e zakonshëm të Shoqërisë.

14.5 Administratori/ët mund të caktojnë përfaqësues të posaçëm ose avokatë për kryerjen e akteve të veçanta ose të një kategorie aktesh, duke përcaktuar saktë kompetencat përkatëse.

14.6 Në kundërshtim të njërit prej administratorëve ndaj akteve që synon të kryejë një tjetër, kompetenca për të vendosur mbi kundërshtimin i përket vetëm Asamblesë së Përgjithshme me vendim me 3/4 (tre të katërtat) e kuotave të zotëruar nga ortakët e shoqërisë.

14.7 Administratori përfaqëson dhe vepron në emër të shoqërisë përpara personave të tretë, personave fizik, personave juridikë publike ose privat, autoriteteve shtetërore, autoriteteve gjyqësore të të gjitha shkallëve dhe përpara çdo personi privat ose publik të huaj.



## **KREU IV**

### **NENI 15 TË DREJTAT E ORTAKËVE**

15.1 Ortaku gëzon këto të drejta:

- Pjesëmarrjen në rezultatet e cdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë, parashikuar në legjislacionin në fuqi dhe Statutin e Shoqërisë.
- Marrjen e të gjitha të dhënave mbi gjëndjen ekonomike, tregtare, veprimtarinë e Shoqërisë, të gjitha dokumentet apo materialet e përpunuara nga shoqëria, bilancet si dhe llogaritë bankare etj.
- Marrjen e propozimeve, dokumenteve dhe shqyrtimin e tyre nga mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
- Të heqë dorë nga shoqëria, por pa e liruar ortakun nga detyrimet financiare që ky i fundit ka ndaj shoqërisë.
- Të marr pjesë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij ligjorë, në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
- Të kërkojë ti jepen informacione që kanë të bëjnë me produktivitetin, gjëndjen dhe ecurinë e politikave tregtare të Shoqërisë.
- Të bëjë propozime dhe ti paraqesë ato për shqyrtim para Asamblesë së Përgjithshme.
- Të emërojë dhe shkarkojë nëpërmjet procesit të votimit administratorin/ët, përfaqësuesit e saj, punonjësit e saj ekspertin kontabël apo likuidatorët.
- Të heqë dorë nga Shoqëria, duke i njoftuar vendimin e tij Asamblesë së Përgjithshme 6 muaj përpara dhe duke ceduar të drejtën e zgjedhjes. Heqja dorë nuk e liron ortakun nga detyrimet ndaj Shoqërisë apo anasjelltas.

### **NENI 16 DETYRIMET E ORTAKËVE**



16.1 Ortaku ka këto detyrime:

- Të depozitojë kuotat e tij dhe kuotat suplementare në përputhje me kushtet e parashikuara në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë.
- Të marr pjesë në administrimin e Shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara prej saj.
- T'i japin Shoqërisë të dhënat e domosdoshme për realizimin apo përpunimin e cdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat dhe shërbimet e nevojshme për realizimin e objektivave dhe funksioneve të Shoqërisë.

### **NENI 17 FINANCIMI I ORTAKËVE**

Shoqëria mund të marrë nga ortakët kontribute në natyrë, kontribute në të holla dhe hua me ose pa kamatë në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore në fuqi.

### **NENI 18 PJESËMARRJA NË SHOQËRI TË TJERA**



17.1 Ortakët mund të vendosin lirisht pjesëmarrjen në persona juridikë privatë të tjerë apo të kryejnë çdo lloj aktiviteti tregtar në territorin e Shqipërisë, me kushtin që mos të jenë konkurrues me objektin e Shoqërisë.

17.2 Çdo veprimtari që bie ndesh me termat e mësipërm, nuk do të konsiderohet si konflikt interesi nëse merr votëbesimin e të paktën 3/4 (tre të katërtat) e kuotave të zotëruara prej ortakëve të shoqërisë.

## **NENI 19 LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE**

Asambleja e Përgjithshme mund të marr vendim për largimin ose përjashtimin nga shoqëria të një ortaku në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", legjislacionit përkatës në fuqi dhe këtij Statuti.

## **KREU V**

### **NENI 20 VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

20.1 Viti financiar fillon me datë 01 Janar dhe mbyllet me datë 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo viti financiar Administratori procedon në hartimin e bilancit të vitit ushtrimor brenda afateve dhe në përputhje me dispozitat e ligjit.

20.2 Dokumentet e kontabilitetit, të shoqëruar, nëse janë të nevojshëm nga raporti i ekspertëve kontabël të autorizuar duhet tu komunikohen dhe vihen në dispozicion të gjithë ortakëve pranë selisë së Shoqërisë të paktën pesëmbëdhjetë ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë.

20.3 Viti i parë financiar fillon në datën e themelimit të shoqërisë dhe përfundon më 31 dhjetor të atij viti.

### **NENI 21 RIORGANIZIMI DHE PRISHJA E SHOQËRISË**



21.1 Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet ndërrimit të formës ligjore.

21.2 Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

21.3 Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

21.4 Shoqëria nuk priset në rastin e humbjes së zotësisë, vdekjes ose falimentit të njërit prej ortakëve.

21.5 Në rast prishjeje Shoqëria do të nënshtrohet procedurës së likuidimit, sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar në fuqi.





**NENI 22**  
**LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Veprimtaria e Shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, si dhe nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 23**  
**MOSMARRVESHJET**


Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve, administratorit apo palëve të treta për zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti apo çdo mosmarrëveshjeje tjetër midis Shoqërisë dhe palëve të treta duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast mos zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, palët do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 24**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Ky Statut u hartua në 4 ekzemplarë me përmbajtje të njëjtë dhe në gjuhën shqipe. Statuti u lexua dhe miratua nen për nen, nga ortakët themelues, duke e nënshkruar atë në çdo faqe dhe **duke autorizuar administratorin e saj, Z. Endrit Molla për depozitimin e tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit**. Ky Statut hyn në fuqi menjëherë.

**ORTAKËT THEMELUES**

**Z. FATJON MOLLA**



**Z. ENDRIT MOLLA**

